



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT,  
SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

MINISTRIA E FINANCEVE  
DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 4460 / 1 Prot. Tiranë, më 16. 8. 2021

Nr. 14353 / 1 Prot. Tiranë, më 16. 8. 2021

### U DH Ë Z I M I P Ë R B A S H K Ë T

Nr. 17, datë 16. 8. 2021

### P Ë R VITIN SHKOLLOR 2021-2022 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenit 8 të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

### U D H Ë Z O J M Ë:

#### K R E U I V E P R I M T A R I A N Ë I N S T I T U C I O N E T A R S I M O R E P A R A U N I V E R S I T A R E

#### I.1. ARSIMI PARASHKOLLOR

Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e kopshteve, të ndjekin me përparësi:

1. Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të jashtme e të brendshme të kopshtit sa më të sigurta, nxitëse dhe gjithëpërfshirëse, që të mundësojnë zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.
2. Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë të stafit të kopshteve me prindërit dhe komunitetin, për krijimin e një modeli të ri të sjelljes së fëmijëve, mësuesve dhe prindërve në mjediset e kopshtit dhe jashtë tyre, bazuar në protokollat e situatës COVID-19.

3. Regjistrimin me përparësi në kopsht të fëmijëve me nevoja të veçanta (nga familjet në nevojë, romë, egjiptianë dhe fëmijë me aftësi të kufizuara).
4. Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi.
5. Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga mësuesit e arsimit parashkollor në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale të specializuara.
6. Pajisjen e fëmijëve që përfundojnë të paktën grupin e tretë të kopshtit ose klasën përgatitore dhe kanë moshën për të ndjekur klasën e parë, me vërtetimin e ndjekjes së kopshtit për grupin përkatës, të nënshkruar nga drejtuesi i kopshtit.
7. Ngritjen në çdo kopsht të bordit, këshillit të prindërve, këshillit të mësuesve dhe komisionit të etikës e sjelljes, sipas legjislacionit në fuqi.
8. Trajtimin me përparësi nga këshillat e mësuesve dhe rrjetet profesionale të temave të mëposhtme:
  - a) Standardet e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç.
  - b) Kurrikula me kompetenca dhe planifikimi sipas saj në arsimin parashkollor.
  - c) Portofoli i të nxënimit.
  - ç) Vlerësimi i fëmijëve.
  - d) Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor.
  - dh) Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor.
  - e) Arsimi gjithëpërfshirës.

## I.2. ARSIMI BAZË

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, të ndjekin me përparësi:

1. Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të jashtme e të brendshme të shkollës sa më të sigurta, nxitëse dhe gjithëpërfshirëse.
2. Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë të stafit me prindërit dhe komunitetin, për krijimin e një modeli të ri të sjelljes së nxënësve, mësuesve dhe prindërve në ambjentet e shkollës dhe jashtë saj, bazuar në protokollin e situatës së COVID-19.
3. Zbatimin e udhëzuesve të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët për përsëritjen dyjavore të temave mësimore për të cilat janë evidentuar mangësi për shkak të zhvillimit të mësimin në kushtet e pandemisë. Ky proces do të realizohet gjatë periudhës 01-10 shtator 2021.
4. Zbatimin e Urdhrit Nr. 127, datë 01.06.2021, "Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë" për klasën I (parë), si më poshtë:

<b>FUSHA/LËNDËT</b>	<b>Orët javore</b>
<b>GJUHËT DHE KOMUNIKIMI</b>	<b>10</b>
Gjuhë shqipe	8
Gjuhë angleze	2
Gjuhë e huaj e dytë	
<b>MATEMATIKË</b>	<b>4</b>
<b>SHKENCAT E NATYRËS</b>	<b>1</b>
Dituri natyre	1
Fizikë	
Kimi	
Biologji	
<b>SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>1</b>
Edukim për shoqërinë	1
Qytetari	
Histori	
Gjeografi	
<b>ARTE</b>	<b>2</b>
Muzikë	1
Art pamor	1
Kërcim	
Teatër	
<b>EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI</b>	<b>3</b>
<b>TEKNOLOGJI DHE TIK</b>	<b>0</b>
<b>TIK</b>	<b>0</b>
Aftësimi teknologjik praktik	
<b>KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE</b>	<b>1</b>
<b>Totali (Orë javore)</b>	<b>22</b>

5. Zbatimin e Urdhrit Nr. 128, datë 01.06.2021, "Për miratimin e programit të gjuhës angleze për klasën e parë".
6. Pajisjen e nxënësve të klasës së parë me tekstet e gjuhës angleze, pjesë e katalogut të teksteve shkollore 2021-2022, sipas Urdhrit Nr. 271, datë 21.07.2021, "Për një shtesë në Urdhrin Nr. 46, datë 16.03.2021, "Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1,2,3,4,9,10,11,12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022".
7. Zhvillimin profesional të mësuesve të gjuhës angleze në klasën e parë.
8. Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi.

9. Zbatimin nga institucionet arsimore të planit të veprimit të hartuar prej tyre (DRAP/ZVAP) për mbështetjen e arsimit në gjuhën amtare të fëmijëve të pakicave kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive të veçanta në institucionet publike të arsimit parauniversitar ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave kombëtare.
10. Regjistrimin me përparësi në shkollë të fëmijëve nga shtresat në nevojë, romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuara, të kthyer nga emigracioni, të fëmijëve viktime apo viktime të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore etj.
11. Ndjekjen dhe përfundimin e arsimit bazë nga fëmijët romë, sipas deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për romët.
12. Raportimin nga DPAP/DRAP/ZVAP-të brenda afateve në MASR të të dhënave statistikore në arsimin bazë sipas kërkesave të institucionit dhe pasqyrave të miratuara nga INSTAT.
13. Funkionimin e rrjeteve profesionale të mësuesve dhe shërbimit psiko-social.
14. Trajnimin e rrjeteve profesionale të mësuesve të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave, si lëndë që lidhen me aftësitë që vlerëson PISA.
15. Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara.
16. Sigurimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme.
17. Koordinimin dhe realizimin e veprimtarive për mbrojtjen e fëmijëve në internet.
18. Zbatimin e veprimtarive në kuadrin e projektit *e-twinning*, në përputhje me Urdhrin Nr. 34, datë 24.02.2021, "Për realizimin e planit të aktiviteteve në kuadër të programit *e-twinning*, për periudhën 2021-2022 në përputhje me kushtet e marrëveshjes".
19. Zbatimin e nismës "Tri lëndë në gjashtë orë".
20. Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive për parandalimin e dhunës në shkollë.
21. Mësimin e gjuhëve të huaja në arsimin bazë:
  - a. Të sigurohet zhvillimi i gjuhës së huaj në arsimin bazë, në mënyrë që nxënësit të jenë të përgatitur për provimin e gjuhës së huaj në provimet kombëtare të arsimit bazë 2022, për të gjithë ata që nuk kanë zhvilluar gjuhë të huaj në vitin shkollor 2020-2021.
  - b. Të sigurohet vijimësia e gjuhës së huaj të parë, të nisur në klasën III të arsimit fillor, dhe të gjuhës së huaj të dytë, të nisur në klasën VI.
  - c. Të zbatohen memorandumet dhe marrëveshjet dypalëshe si vijon:
    - i. për gjuhën italiane, vijon zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit miratuar më 18.05.2021 për programin "Iliria". Planifikimi i shkollave që do të zhvillojnë gjuhën italiane, është kompetencë dhe përgjegjësi e ZVAP-ve;
    - ii. për gjuhën frënge, vijon zbatimi i angazhimeve në kuadër të aderimit në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe Memorandumit të Partneritetit mbi "Bashkëpunimin Arsimor të Kuadrit Strategjik të Frankofonisë 2015-2022";
    - iii. ZVAP-të Elbasan, Durrës, Korçë, Shkodër dhe Tiranë, në shkollat e të cilave funksionojnë klasat mbështetëse për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, shqiptaro-franceze dhe shqiptaro-gjermane, të sigurojnë hapjen e klasave në

shkollat e përcaktuara në memorandumet, duke filluar në klasën III të arsimit fillor dhe në klasën VI të arsimit të mesëm të ulët për fazën tranzitore;

- iv. DRAP-ja, për çdo ZVAP në varësi, raporton planifikimin për secilën gjuhë të huaj në DPAP e cila, brenda datës 30 shtator 2021, raporton në MASR.

22. Zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe raportimin çdo tre muaj nga DPAP-ja në MASR për ecurinë e kësaj nisme.
23. Zbatimin e projekteve “Miq të ujit” dhe “Sfida botërore e monitorimit të ujit”, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara midis MASR-së dhe SHUKALB.
24. Zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet MASR-së dhe UNFPA-së, për programin “Edukimi shëndetësor me fokus aftësitë për jetën dhe edukimin seksual”.
25. Klasat e profilizuara në sport:
- Klasat e profilizuara në sport krijohen në disiplina të ndryshme sportive, sipas kërkesave të nxënësve, vetëm në fillim të vitit shkollor dhe pas miratimit nga DRAP-ja.
  - Drejtuesit e ZVA-ve dhe/ose drejtorët e shkollave 9-vjeçare kërkojnë në DRAP hapjen e klasës së profilizuar në sport, vetëm nëse shkolla plotëson kushtet e infrastrukturës dhe kriteret e mësimdhënies së personelit të edukimit fizik.

### **I.3 ARSIMI I MESËM I LARTË**

#### **I.3.1 GJIMNAZET**

DRAP dhe ZVAP dhe drejtuesit e gjimnazeve, të ndjekin me përparësi:

- Marrjen e masave për krijimin e një mjedisi të jashtëm dhe të brendshëm të shkollës sa më të sigurt nxitës dhe gjithëpërfshirës.
- Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë të stafit me prindërit dhe komunitetin, për krijimin e një modeli të ri të sjelljes së nxënësve, mësuesve dhe prindërve në ambientet e shkollës dhe jashtë saj, bazuar në protokollet e situatës së COVID-19. Zbatimin e udhëzuesit të ASCAP-it për arsimin e mesëm të lartë për përsëritjen dyjavore të temave mësimore për të cilat janë evidentuar mangësi për shkak të zhvillimit të mësimin në kushtet e pandemisë. Ky proces do të realizohet gjatë periudhës 01-10 shtator 2021.
- Zbatimin e planeve mësimore si më poshtë:
  - plani mësimor i gjimnazit, i miratuar me nr.12789/1 prot., datë 28.12.2017;
  - plani mësimor i gjimnazit gjuhësor, me nr. 5415 prot., datë 26.05.2016;
  - plani mësimor i gjimnazit me kohë të pjeshme, me nr.7380 prot., datë 20.07.2016;
- Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi.
- Zbatimin e programit “Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MASR-së

dhe MBsë nr.7638 datë 16.04.2014, si dhe edukimi i të rinjve me parimet e fair-play (garimi i drejtë) dhe rreziqet e dopingut ndaj shëndetit, dëmin që shkakton ai në vlerat etike të sportit, në zbatim të ligjit nr. 9242, datë 17.6.2004, "Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989".

6. Koordinimin, në zbatim të kontratës që MASR-ja ka me Komisionin European për zbatimin e programit *e-Twinning*, program i Erasmus Plus për arsim dhe edukim.
7. Regjistrimin me përparësi të nxënësve nga komuniteti rom dhe egjiptian dhe përfundimin prej tyre të arsimit të mesëm të lartë.
8. Zbatimin e projektit "Panairi shkencor", në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar midis MASR-së dhe SHUKALB.
9. Raportimin brenda afateve në MASR të të dhënave statistikore në arsimin e mesëm të lartë sipas kërkesave të institucionit dhe pasqyrave të miratuara nga INSTAT.

### **I.3.2 ARSIMI I ORIENTUAR**

#### **3.2.1 Shkollat e mesme të gjuhëve të huaja**

1. T'i zgjedhin vetë tekstet shkollore për lëndën e gjuhës së huaj, nëse ato që janë në katalogun 2021-2022, nuk përmbushin kërkesat kurrikulare të kësaj lënde.
2. Të punojnë me grupe në lëndën e gjuhës së huaj, në përputhje me Udhëzimin Nr. 30, datë 12.09.2018, "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar.

#### **3.2.2 Shkollat me drejtim të orientuar punojnë me planet mësimore si më poshtë:**

- plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), shkolla koreografike, me nr. 2434/1prot., datë 18.05.2020;
- plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), degët "Arti figurativ", "Qeramikë", "Gdhendje gur dhe dru", me nr.6855/2 prot., datë 30.08.2019;
- plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), degët "Arti figurativ", "Grafika", "Skenografi", "Tekstil", "Fotografia artistike", me nr.6855/3 prot., datë 30.08.2019;
- plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), degët "Muzikë", "Fizarmonikë", "Korno", "Trombë", "rombon", "Perkusion", "Fagot", "Kitarë", "Kanto", "Flaut", "Oboe", "Saksofon", "Bastub", me nr.6855/4 prot. datë 30.08.2019;
- plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), degët "Muzikë", "Piano", "Violinë", "Violë", "Violonçel", "Kontrabas", "Kitarë", "Flaut", "Klarinetë", "Fizarmonikë", me nr.6855/6 prot. datë 30.08.2019;
- plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive), shkolla "Loro Boriçi", me nr.5418 prot., datë 26.05.2016;
- plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive), shkolla "Benardina Qerraxhia", me nr.4116/1 prot., datë 11.09.2020.

### **I.3.3 SEKSIONET SHKOLLORE DYGJUHËSHE**

1. DRAP-të dhe ZVAP-të, të cilat kanë seksione shkollore dygjuhëshe, të zbatojnë:
  - a. Marrëveshjen nr.6045 prot., datë 13.6.2016, midis ministrisë përgjegjëse për arsimin të Republikës së Shqipërisë dhe ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe zhvillimin ndërkombëtar të Republikës së Francës mbi “Bashkëpunimin në fushën e arsimit dygjuhësh”.
  - b. Memorandum i Mirëkuptimit mes Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë mbi funksionimin e seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-italiane, nënshkruar më 12.12.2019.
  - c. Memorandumin e Bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë mbi seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman dhe planet mësimore për seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman, miratuar me shkresën nr.7496 prot., datë 22.07.2016.
2. DPAP-ja të raportojë në MASR deri më 10 shtator 2021 për ecurinë e regjistrimit të nxënësve në seksionet dygjuhëshe.

### **I.3.4 ARSIMI PROFESIONAL (AP)**

1. Aspektet e kulturës profesionale në arsimin e mesëm profesional, për vitin shkollor 2021-2022, rregullohen me akte të posaçme në përputhje me ligjin nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
2. Për Maturën Shtetërore Profesionale:

Rregullorja e zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2022, përfshirë dhe Maturën Shtetërore Profesionale dhe udhëzimet përkatëse, do të miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

### **I.4 ARSIMI PARAUNIVERSITAR PRIVAT**

1. DRAP-të dhe ZVAP-të:
  - a) Të mbajnë kontakte të vazhdueshme me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat, t’i informojnë rregullisht për çdo ndryshim apo akt të ri ligjor dhe t’i monitorojnë për realizimin e planeve dhe programeve mësimore.
  - b) Të kërkojnë të dhënat statistikore që lidhen me gjithë procesin mësimor, si: numrin e nxënësve të regjistruar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, braktisjen, kalueshmërinë, të dhëna për stafin mësimor dhe drejtues, si dhe të dhëna të tjera sipas kërkesës.
  - c) Të bëjnë vlerësimin e kritereve të ligjshmërisë për çdo institucion arsimor dhe të raportojnë në DPAP, e cila raporton në MASR.

- c) Të sistemojnë nxënësit, në rast mbylljeje të institucioneve arsimore private.
2. Institucionet arsimore parauniversitare private:
- Të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në fillim të vitit shkollor, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve, sipas statistikave të miratuara, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe planin vjetor të shkollës sipas formatit të parashikuar në Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare.
  - Të zbatojnë Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, për transferimin e nxënësve, si edhe Udhëzimin Nr. 21, datë 9.7.2015, "Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në gjimnaz".
  - Të realizojnë detyrimet e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit (regjistra, amza, evidenca për lëvizjet e nxënësve, rregullore e brendshme e kopshtit/shkollës, dëftesa, kontrata me prindërit etj.), sipas Udhëzimit Nr. 15, datë 12.7.2013, "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar.
  - Institucionet mund ta ndërpresin veprimtarinë e tyre arsimore vetëm në fund të vitit shkollor. Për mbylljen e veprimtarisë së tij arsimore duhet të njoftojnë DRAP-në dhe ZVAP-në, MASR-në, QKB-në dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e plotë në ZVAP-në përkatëse.
3. Institucionet arsimore parauniversitare private që funksionojnë në gjuhë të huaj, të bashkëpunojnë me ZVAP-në përkatëse për njoftimin në kohë të maturantëve të cilët dëshirojnë të vijojnë studimet e larta në IAL-të e vendit për zbatimin e procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Maturës Shtetërore të vitit përkatës. Për maturantët që dëshirojnë të vijojnë studimet e larta jashtë vendit, të bashkëpunojnë me përfaqësitë e huaja të shtetit përkatës për njohjen e kritereve të aplikimeve në universitet e huaja.

## **1.5 REGJISTRIMI I NXËNËSVE DHE PAJISJA ME TEKSTE SHKOLLORE**

- Regjistrimet e nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar të bëhen në përputhje me Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare.
- Drejtoritë e shkollave të afishojnë, në vend të dukshëm të shkollës, listën e teksteve shkollore, ku shënohen titulli, shtëpia botuese, çmimi i tekstit, për çdo klasë të shkollës, vendi ku do të shpërndahen tekstet si dhe periudha, sipas një grafiku për çdo klasë.
- Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi:
  - procesin e shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore për të gjithë nxënësit para fillimit të procesit mësimor;



- b) procesin e pajisjes me tekste shkollore në përdorim falas për klasat I-IX të arsimit bazë, si dhe pajisjen me tekste shkollore falas të të gjitha kategorive të përcaktuara në VKM-në përkatëse.
4. DPAP-ja të raportojë zyrtarisht në MASR për ecurinë e procesit të pajisjes së të gjithë nxënësve me tekste shkollore, me fokus kategoritë e veçanta, në përputhje me VKM-në nr. 486, datë 17.6.2020, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar” dhe me Udhëzimin e MASR-së Nr. 21, datë 13.08.2020, “Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollore në përdorin falas në arsimin parauniversitar”.

## **I.6 NDALIMI I PËRDORIMIT TË TELEFONIT CELULAR**

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore të marrin masa për zbatimin me përparësi të Urdhrit Nr. 493, datë 30.7.2018, “Për mospërdorimin e telefonit celular gjatë procesit mësimor në shkollë”, dhe të Udhëzimit Nr. 34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare, si nga mësuesit ashtu dhe nga nxënësit”.
2. Masat për ndalimin e përdorimit të telefonit celular të pasqyrohen në rregulloren e brendshme që hartohet në bashkëpunim me organizmat e institucionit arsimor.

## **KREU II POLITIKA, STRATEGJI, MARRËVESHJE**

### **II.1 REDUKTIMI I BRAKTISJES SHKOLLORE**

1. Për reduktimin e braktisjes shkollore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të zbatojnë me përgjegjësi Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 7522 prot., datë 12.7.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore”, ndërmjet MASR-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Ministrisë së Brendshme (MB) dhe Urdhrin e Përbashkët të MASR-së, MB-së dhe MShMS-së Nr. 292, datë 28.05.2019, “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor””.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:
  - a) të monitorojnë shkollat lidhur me raportimin real të nxënësve braktisës, potencial për braktisje dhe fëmijëve jashtë sistemit arsimor;

- b) të koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe organizatave të shoqërisë civile për zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës dhe të fëmijëve në situatë rruge;
- c) të ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve të ngujuar dhe zbatimin e procedurave të ndjekjes së arsimit bazë, sipas udhëzimit përkatës për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë;
- ç) të raportojnë në DRAP dy herë në vit (në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor) punën e bërë për reduktimin e braktisjes shkollore. DRAP-të raportojnë në DPAP, e cila përcjell raportin në MASR;
- d) të plotësojnë sistemin "Romalb" për të gjithë treguesit e formularit online, brenda afatit që do të caktojë MShMS-ja, si administratore e këtij sistemi.

## II.2 SHKOLLA QENDER KOMUNITARE

1. Konsolidimi i shkollave qendra komunitare (ShQK), bazuar në Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare, miratuar me shkresën nr. 1794 prot., datë 13.3.2014 dhe udhëzuesin për ShQK, tetor 2014, në këto aspekte:
  - a) ShQK-të të vlerësohen për përmbushjen e standardeve dhe kritereve të përcaktuara për ShQK-në, si dhe përcaktimin e qartë të fushave në bazë të vlerësimit të bërë përmes portalit të ShQK;
  - b) shkollat, pjesë e programeve të bashkëpunimit me partnerët Save the Children, World Vision, UNICEF, UNDP, të vijojnë të jenë pjesë e ShQK-së dhe të bashkëpunohet për përmbushjen e angazhimeve dypalëshe dhe të projekteve në proces.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar,:
  - a) të vlerësojnë shkollat qendër komunitare në përputhje me kriteret;
  - b) të marrin masat e nevojshme për këshillimin, informimin, trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të mësuesve koordinatorë, strukturave të shkollës, grupimeve nga komuniteti, në bashkëpunim me ZVAP/DRAP/DPAP/ASCAP-in dhe partnerët;
  - c) të trajnojnë dhe të rritin kapacitetet e mësuesve koordinatorë, strukturave të shkollës, grupimeve nga komuniteti, në bashkëpunim me ASCAP-in dhe partnerët;
  - ç) të promovojnë praktikat më të mira të ShQK-ve dhe të shkëmbejnë përvojat mes shkollave;
  - d) të marrin masat për menaxhimin sa më efektiv të 10 orëve javore të planifikuara për ShQK-në.
3. Karta e Performancës e vitit shkollor 2020-2021 dhe për vitin shkollor 2021-2022:
  - a) Shkollat të llogarisin edhe ndryshimet në vlerë për treguesit e pasqyruar një vit më parë.
  - b) Në dërgimin e të dhënave që burojnë nga shkolla, të sqarohet edhe procedura e përpunimit të të dhënave siç është përcaktuar në Udhëzuesin për Kartën e Performancës së Shkollës.

- c) Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mund të vendosin të kenë tregues rajonalë ose jo (p.sh., të dhëna për lëndët me zgjedhje, arritjet e nxënësve me AK etj.).
- ç) Çdo shkollë në arsimin parauniversitar, deri më 03.09.2021, të plotësojë Kartën e Performancës së Shkollës për vitin shkollor 2020-2021, si dhe ta bëjë atë publike për prindërit dhe komunitetin.
- d) ZVAP-të të verifikojnë të dhënat e dërguara nga shkollat deri më 10.09.2021.
- dh) Në fund të muajit shtator 2021, ZVAP-të të shpallin shkollat e suksesshme në zbatim të të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare.
- e) Shkollat të hartojnë Kartën e Performancës së Shkollës për vitin shkollor 2021-2022, bazuar në Udhëzuesin për Kartën e Performancës së Shkollës, MAS, 2014.
- ë) Çdo shkollë e arsimit parauniversitar të hartojë Kartën e Performancës së Shkollës me treguesit e përzgjedhur.
- f) Shkollat të llogarisin edhe ndryshimin në vlerë për treguesit e pasqyruar në Kartën e Performancës së vitit paraardhës.

#### 4. "Stop dhunës në institucionet arsimore".

ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore të marrin masa për:

- a) Planifikimin vjetor të veprimtarive ndërgjegjësuese me fokus parandalimin dhe minimizimin e dhunës në institucionet arsimore.
- b) Ngritjen e këndit "Stop dhunës në shkollë".
- c) Monitorimin dhe përmirësimin e punës të komisioneve të disiplinës dhe të komisioneve të etikës dhe të sjelljes për trajtimin e rasteve të çdo lloji të dhunës në institucionet arsimore.
- ç) Raportimin në DPAP, sipas formateve të përcaktuara, të rasteve të dhunës në institucionet arsimore, të trajtuara nga komisionet e etikës, si dhe raportin narrativ për punën e bërë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, brenda datës 30.05.2022.

DRAP raportin përmbledhës të ZVAP-ve nën juridiksionin e saj e dërgon në DPAP. DPAP-ja harton raportin përmbledhës dhe e dërgon në MASR, brenda datës 1 korrik 2022.

#### 5. Lufta kundër bullizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor shqiptar

Në këtë kuadër, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore të marrin masat si vijon:

- a) të ngrihen ekipet "antibulling" në çdo shkollë si dhe të hartohen planet vjetore për luftën kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm;
- b) të hartohet plani i veprimeve i mbështetur në dokumentet e hartuara nga projekti i përbashkët i MASR-së me Këshillin e Europës;
- c) të koordinohen veprimtaritë ndërgjegjësuese ndërmjet shkollave, ku rolin drejtues për organizimin e aktiviteteve ta marrin shkollat që ishin pjesë e projektit;
- ç) të planifikohet, sipas një kalendarit, organizimi i veprimtarive ndërgjegjësuese të datës 21 nëntor 2021, "Ditës kombëtare kundër bullizmit";

- d) të angazhohen mësuesit e trajnuar për luftën kundër bullizmit për ndarjen e njohurive dhe përvojave në shkollat e tjera, duke përdorur modulën e akredituar nga KAPT-i me vendimin nr. 20, datë 19.12.2017, "Parandalimi dhe trajtimi i bullizmit, dhunës dhe ekstremizmit në shkollë";
  - dh) të hartohet plani i veprimeve për çdo shkollë për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm;
  - e) të konsolidohet rrjeti i mësuesve koordinatorë për parandalimin e ekstremizimit dhe radikalizmit të dhunshëm në arsimin parauniversitar.
6. DPAP-ja, DRAP-të dhe ZVAP-të të marrin masat për zbatimin e programit të arteve, zejeve dhe sporteve në arsimin parauniversitar.

### II.3 SHËRBIMI PSIKO-SOCIAL (ShPS)

DRAP-të dhe ZVAP-të të monitorojnë realizimin e planit të punës të njësisë të ShPS-së dhe të raportojnë në DPAP në janar 2022 dhe në qershor 2022. DPAP-ja të raportojë në MASR.

### II.4 ZBATIMI I STRATEGJIVE NDËRSEKTORIALE DHE I PLANEVE KOMBËTARE TË VEPRIMIT

1. DPAP-ja dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në bazë të planit të veprimit për zbatimin e secilës strategji kombëtare ndërministrare:
  - a) të caktojnë personat përgjegjës;
  - b) të hartojnë plane pune vjetore me detyra dhe afate konkrete;
  - c) të monitorojnë realizimin e veprimtarive;
  - ç) të raportojnë rregullisht për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga këto strategji.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të raportojnë në DPAP (DPAP-ja raporton në MASR) sipas kërkesës së MASR-së, për ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre për strategjitë dhe planet kombëtare të mëposhtme:
  - a) Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, miratuar me VKM nr. 276, datë 12.5.2021.
  - b) Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit, 2021-2025, dhe plani i veprimit 2021-2023, miratuar me vendim nr. 1137, datë 16.12.2020.
  - c) Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe plani i veprimit 2021-2023, miratuar me vendim nr. 1139, datë 24.12.2020.
  - ç) Plani Kombëtar për Kontrollin e Drogës (2019-2023) dhe Plani i tij i punës 2019-2023.
  - d) Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe plani i veprimit, miratuar me vendim nr. 400, datë 30.06.2021.
  - dh) Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit dhe plani i veprimit, miratuar me vendim nr. 412, datë 19.06.2019.

- e) Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe plani i veprimit, miratuar me vendim nr. 47/2019.
- ë) Strategjia Kombëtare për Migracionin 2019-2022 dhe plani i veprimit, miratuar me vendim nr. 400, datë 19.06.2019.
- f) Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025 dhe plani i veprimit, miratuar me vendim nr. 903, datë 24.12.2019.
- g) Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2018-2021 dhe plani i veprimit, miratuar me vendim nr. 541, datë 19.09.2018.
- gj) Të gjitha strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit që do miratohen gjatë vitit 2021-2022 dhe përcaktojnë masa për institucionet arsimore, pas konfirmimit nga MASR-ja.
- h) Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 4481 prot., datë 25.4.2018, ndërmjet MASR-së dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë. Për zbatimin e kësaj marrëveshje çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të identifikojë fëmijët me probleme të të dëgjuarit, të cilët nuk frekuentojnë shkollën, si dhe të marrë masa për përfshirjen e tyre në arsimin bazë, të zakonshëm apo special, në varësi të nivelit të paaftësisë.
- i) Memorandumi i Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Korpusit të Paqes, datë 7 maj 2019. Për këtë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të informojnë institucionet arsimore që ato të marrin masat si vijon:
- të përfshijnë vullnetarin/en në takimet e organizuara në shkollë për procesin e bashkëmësimdhënies dhe të projekteve të ndryshme në interes të shkollës;
  - të mbështesin mësuesit të marrin pjesë në trajnimet që zhvillon/sponsorizon Korpusi i Paqes;
  - të përfshijnë vullnetarin/en në organizimin dhe zbatimin e veprimtarive dhe të projekteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet;
  - të mbështesin vullnetarin/en në zbatimin e nismës për të zhvilluar aftësitë në gjuhën angleze të mësuesve të lëndëve të tjera.
- j) Marrëveshje Bashkëpunimi midis Federatës Botërore të Shahut, Federatës Shqiptare të Shahut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 4661/1, datë 18.06.2015, objekt i së cilës është implementimi i projektit “Mësime të shahut në shkolla”.
- k) Marrëveshje Bashkëpunimi midis Federatës Shqiptare të Xhudos dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 9322, datë 12.11. 2015, për implementimin e projektit “Mësime të xhudos në shkolla”.
- l) Marrëveshje Bashkëpunimi midis Federatës Shqiptare të Hendbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 4073, datë 18.04.2016, objekt i së cilës është implementimi i projektit “Mësime të hendbollit në shkolla”.
- ll) Marrëveshje Bashkëpunimi midis Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 1660, datë 12.12.2017, për implementimin e projektit “Mësime të futbollit në shkolla (Grow 2020)”.

- m) Marrëveshje Bashkëpunimi midis Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2028/1, datë 23.02.2018, për implementimin e projektit "Mësime të Basketbollit në shkolla".
- n) Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016 dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, "Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë", ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të koordinojë veprimtaritë kulturore, artistike, figurative që mundëson ky memorandum.
- nj) Memorandumi i Mirëkuptimit nr. 2436 prot., datë 28.2.2019, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Këshillit Britanik në Shqipëri për zbatimin e projektit "Shkollat e shekullit 21". Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të koordinojë veprimtaritë që mundëson ky memorandum, duke organizuar dhe zhvilluar trajnimet me mësuesit dhe drejtuesit e shkollave të arsimit bazë për aftësitë e të menduarit kritik, zgjidhjes problemore dhe kodimit, për përdorimin e pajisjeve *micro bit* dhe mënyrën e integritit të këtyre aftësive në praktikë, në klasë.
- o) Në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës dhe Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) do të vijojë me përparësi zbatimi i projektit "Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri". Ky projekt do të zbatohet në shkollat e përzgjedhura në bashkëpunim nga Këshilli i Evropës dhe MASR.
- p) Në kuadër të bashkëpunimit me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, të vijojë zbatimi i projektit "Shkollat për shëndetin".
- q) Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. 1988-2, datë 14 Prill 2021, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Albanian-American Development Foundation për zbatimin e programeve të "Junior Achievement of Albania". Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të koordinojë veprimtaritë që mundëson ky memorandum, duke u angazhuar në mbështetje të ekspertëve të huaj dhe vendas, të cilët do të zbatojnë aktivitetet e programeve "Junior Achievement of Albania".

### KREU III VEPRIMTARI PLOTËSUESE DHE JASHTËSHKOLLORE

Në zbatim të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore, për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore:

- I. ZVAP-të dhe institucionet arsimore të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë veprimtari me përfshirjen e të gjithë nxënësve, si më poshtë:
  - a) Kampionati Kombëtar i Shahut për arsimin 9-vjeçar, në bashkëpunimin me Federatën Shqiptare të Shahut. Faza e parë të zhvillohet në bazë shkolle në muajin dhjetor, faza e dytë në bazë qarku në muajin shkurt dhe finalja në mars-prill.

- b) Java Olimpikë (prill-maj).
- c) Olimpiadat kombëtare që zhvillohen në datat e përcaktuara në udhëzuesin vjetor të miratuar nga MASR.
- ç) Dita Evropiane e Gjuhëve, 26 shtator 2021.
- d) Dita Botërore e Gjuhës Rome, UNESCO, 5 nëntor 2021.
- dh) Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve, 20 nëntor 2021
- e) Dita e Luftës Kundër Bullizmit, 21 nëntor 2021.
- ë) Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, 3 dhjetor 2021.
- f) Dita e të Drejtave të Njeriut, UNESCO, 10 dhjetor 2021.
- g) Dita Ndërkombëtare e Emigrantëve, UNESCO, 18 dhjetor 2021.
- gj) Përkujtimi i Holokaustit dhe i krimeve kundër njerëzimit, 27 janar 2022.
- h) Dita Botërore e Gjuhës Amtare, 21 shkurt 2022.
- i) Dita Ndërkombëtare kushtuar Sportit për Zhvillim e Paqe, 6 prill 2022.
- j) Dita Ndërkombëtare e Romëve, 8 prill 2022.
- k) Dita Botërore e Librit, 23 prill 2022.
- l) Dita Ndërkombëtare e-twinning, 7 maj 2022.
- ll) Dita kundër Shfrytëzimit të Punës së Fëmijëve, 12 qershor 2022.
- m) Dita Evropiane e Kujtesës për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare, 23 gusht 2022.
- n) Dita Ndërkombëtare e Edukimit, UNESCO, 24 janar 2022.
- nj) Dita Ndërkombëtare e Matematikës, UNESCO, 14 mars 2022.
- o) Dita Botërore e Poezisë, UNESCO, 21 mars 2022.
- p) Dita Botërore e Ujit, UNESCO, 22 mars 2022.
- q) Dita Ndërkombëtare e Bashkëjetesës në Paqe, UNESCO, 16 maj 2022.
- r) Dita Botërore për Diversitet Kulturor, Dialog dhe Zhvillim, UNESCO, 21 maj 2022.
- rr) Dita Botërore e Mjedisit, UNESCO, 5 qershor 2022.
- s) Dita Ndërkombëtare e Rinisë, UNESCO, 12 gusht 2022..
- sh) Kalendar i Ditëve të Europës dhe veprimtaritë gjithëvjetore për njohjen e institucioneve të Bashkimit Europian dhe të Këshillit të Europës.
- t) Konkursët në nivel institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, me tematikë "Të njohim Europën".
- th) Java Evropiane e Lëvizjes "Now we move".
- u) Ditët e festave kombëtare.

#### KREU IV DISPOZITA KALIMTARE

1. Bazuar në të dhënat dhe në protokollet që përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, si dhe në varësi të situatës pandemike të shkaktuar nga COVID-19, institucionet arsimore mund të zbatojnë skenarët e ndjekur gjatë vitit shkollor 2020–2021.
2. Skenarët janë fleksibël dhe zbatimi i tyre në shkolla varet nga situata lokale e pandemisë ose nga situata që mund të krijohen në shkolla të veçanta. Kjo nënkupton që të tre skenarët mund të zbatohen në të njëjtën kohë në të gjithë vendin, në varësi të situatave të krijuara në shkolla apo qytete të veçanta. Shkollat mund të kombinojnë edhe variantet brenda një skenari në varësi të numrit të nxënësve që kanë në klasa.
3. Në rastet e zbatimit të skenarëve, nga institucionet arsimore do të zbatohen të gjitha rubrikat e përcaktuara në udhëzuesin e ASCAP për vitin shkollor 2020–2021.

#### KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, për zbatimin e këtij udhëzimi.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrim masat e duhura që ky udhëzim të shpërndalet në çdo institucion arsimor dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i arsimit.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

MINISTRI I ARSIMIT,  
SPORTIT DHE RINISË

Evis KUSHI



MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

Anila DENAJ

